

Raport studimi

QËNDRIME DHE PERCEPTIME TË ZGJEDHËSVE SHQIPTARË MBI CILËSINË E PUNIMEVE NË KUVËNDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë, 2020

Raporti u përgatit nga:

Enxhi Nasto

Përgjegjësia për faktet dhe opinionet e shprehura në këtë studim bie ekskluzivisht mbi kontribuesit dhe interpretimet e tyre jo doemos reflektojnë mendimet apo politikat e botuesit.

PËRMBAJTJE

Mirënjohje	5
I. Përmbledhje ekzekutive	7
I.1. Cili është qëllimi i kërkimit?	7
I.2. Cila është metodologjia kërkimore e zbatuar?	8
I.3. Etika në kërkim dhe ruajtja e konfidencialitetit.	8
I.4. Por sa është niveli i interesit të zgjedhësve shqiptarë në ndjekjen e seancave plenare të Kuvëndit?	9
II. Gjetjet kërkimore të studimit	17
II.1. Arsyetime të tjera të dhëna se përse nuk janë shikues të rregullt të seancave plenare të Kuvëndit.	17
II.2. Diagrama logjike e temave	20
II.3. Hierarkia e piramides se 5 problemeve prioritare të studimit	21
III. Përfundimet nga analiza e të dhënave	22
IV. Rekomandimet e propozuara për përmirësimin e këtij parlametarizmi	24
V. Argumenti përmbyllës	26

Ky studim u realizua në kuadër të zgjedhjes së Parlamentit të ri që do të kryhet në 25 Prill 2021, ku shqiptarët presin një ndryshim rrënjësor dhe përmirësim të imazhit të këtij institucioni. Perceptimet dhe qëndrimet e shprehura nga trupi elektoral i vëndit është pasqyra e vërtetë në të cilën reflektohet e gjithë performanca e punës së përfaqësuesve legjislativ të Kuvëndit.

Ky studim i botuar mund të shërbejë si referencë për kërkimet e mëtejshme, pasi prezanton një informacion të thelluar mbi qëndrimet e opinionit publik përkundrejt individëve që kanë një status parlamentar.

Ky studim nuk përmban asnjë qëndrim politik të shprehur mbi partitë politike, por për mënyrën se si deputetët kanë përfaqësuar elektoratin e tyre të deritanishëm dhe sa kanë arritur të justifikojnë votat e fituara nga shqiptarët.

Mirënjohje

Mirënjohje dhe falenderime të thella kolegëve, miqve të mi, individëve të panjohur për mua që u stimuluan nga ideja dhe qëllimi i pastër i këtij kërkimi, që mundësuan shpërndarjen e pyetësorit dhe lobuan për plotësimin e tij për të gjeneruar sa më shumë rezultate që i përafroheshin realitetit. Shpreh falenderime familjes time për mbështetjen emocionale dhe për çdo arritje të timen në aspektin profesional.



I. Përmbledhje ekzekutive

Mediatizimi i seancave plenare të Kuvëndit, ka mundësuar që aktiviteti parlamentar të jetë i pranishëm dhe transparent për të gjithë qytetarët shqiptarë, në mënyrë që ata të jenë në dijeni të veprimtarisë së përfaqësueve të tyre legjislativ. Mundësia për të ndjekur të plotë seancat plenare vjen falë përcaktimit të saj në nenin 43 të Rregullores së Brëndshme, në pjesën e parë ku trajtohet organizimi dhe funksionimi i Kuvëndit të RSH-së. Sot, në një kanal të dedikuar të Radio Televizionit Publik Shqiptar, përmes të cilit merret sinjali edhe për mediat audiovizive private pasqyrohen e gjithë veprimtaria e parlamentit. Për çdo grup interesi, shoqëri civile, apo grupime të tjera të interesuara, ekziston mundësia e të qenurit në dijeni për diskutimet e projektligjeve që pasi të miratohen dhe të hyjnë në fuqi do ndikojnë në jetën publike të vëndit. Po ashtu, në seanca të caktuara (me përjashtim të këtij viti diktuar nga pandemia) ekziston mundësia që grupe të caktuara të interesit, edhe qytetarë të ndjekin nga salla e seancave plenare diskutimin që zhvillohet mbi pr/ligjet në rendin e ditës.

I.1. Cili është qëllimi i kërkimit?

Qëllimi që udhëhoqi gjithë hulumtimin e kryer ishte testimi i opinionit publik mbi imazhin aktual të parlamentarëve në Shqipëri. Kjo punë kërkimore orientohet nga një qëllim racional,

për të kuptuar se perceptimin që ka elektorati pas zgjedhjes së përfaqësuesve në arenën parlamentare dhe cilat janë pikërisht qëndrimet e qytetarëve shqiptarë ndaj deputetëve, duke mënjanuar partitokracinë, sepse nuk është pikërisht ky fokusi i kampionimit të një popullate për këtë çështje të marrë nën shqyrtim. Gjetjet kërkimore nga ky sondazhim i elektoratit synon përmirësimin e imazhit publik të parlamentit në vazhdimësi, në mënyrë që parlamentarët të japin më shumë llogari përpara zgjedhësve të tyre dhe mbi të gjitha të jenë më etik dhe profesional në ruajtjen e interesave të zgjedhësve.

I.2. Cila është metodologjia kërkimore e zbatuar?

Metodologjia kërkimore është mikse, pra është kryer një kombinim i metodës sasiore dhe cilësore nga pikëpamja studimore. Është ndërtuar instrumenti kërkimor i pyetësorit i organizuar në pyetje të hapura dhe të mbyllura. Pyetjet nuk janë formuluar me tendencë për të vendosur në pozita të vështira pjesëmarrësit në këtë kërkim. Në çdo pyetje të mbyllur është vendosur një alternativë që në gjuhën kërkimore quhet “alternativa gri”, në mënyrë që në anketim të ketë komoditet në dhënien ose jo të përgjigjes. Pyetësori përmbillet me një pyetje të hapur ku pjesëmarrësit mund të shprehin argumentet e tyre.

I.3. Etika në kërkim dhe ruajtja e konfidencialitetit.

Ruajtja e anonimatit dhe konfidencialitetit ka qënë një objektiv i rëndësishëm. Janë përcaktuar 4 të dhëna demografike për pjesëmarrësit në pyetësorin online, si gjinia, arsimi, mosha dhe qyteti. Pra, nuk janë kërkuar të dhëna më të detajuara nga kërkuesi

që mund të riskonin anonimatën e pjesëmarrësit. Kërkuesi nuk ka shfaqur asnjë bindje politike në formulimin e pyetjeve si dhe nuk ka shfaqur interes për t'i pyetur qytetarët për këtë aspekt dhe kjo dëshmon se etika e kërkimit është respektuar në nivelet më të larta.

I.4. Por sa është niveli i interesit të zgjedhësve shqiptarë në ndjekjen e seancave plenare të Kuvëndit?


Kjo është një nga pyetjet më të rëndësishme, e cila ka udhëhequr të gjithë aktivitetin kërkimor. Kampionimi në formën e ortekut ka arritur deri në numrin e 1200 pjesëmarrësve, të cilët kanë zgjedhur të përgjigjen me vullnetin e tyre të lirë. 54.9% e pjesëmarrësve i përkasin një niveli të lartë arsimor dhe 39% kanë qënë me një arsim pasuniversitar. Elementi arsimor është një karakteristikë demografike shumë e rëndësishme në këtë rast studimor, për të treguar se përfshirja e elitës së shoqërisë ka qënë pikërisht fokusi kryesor i kampionimit.

Grupmoshat më aktive në plotësimin e këtij pyetësori kanë qënë 25-29 dhe 30-34 vjeç, çfarë na tregon se të rinjtë kanë qënë target grupi më i interesuar për të shprehur perceptimin dhe qëndrimin vetjak përkundrejt performancës së grupeve parlamentare në Kuvend. Për nga pikëpamja gjinore, evidentojmë se 51.6% kanë qënë pjesëmarrës të gjinisë mashkull dhe 48.4% të gjinisë femër. Duhet nënvizuar se ekziston një marrëdhënie “kontraktuale” midis anëtarëve të parlamentit dhe vetë elektoratit, sepse nëpërmjet këtyre të fundit ato gra dhe ata burra janë pjesë e “tempullit të demokracisë”, sikundër e ka emërtuar Dr. Ylli Bufi në një botimin e tij. Dhe në emër të kësaj, vendimmarrësit që kanë në duart e tyre fatet e kombit, kanë një përgjegjëshmëri ligjore,


profesionale dhe morale përkundrejt atyre që përmes votës iu dhanë statusin e deputetit.

Në cilëndo qeveri e sidomos në qeveritë e forta autoritariste, i përfaqësuari krijon një lidhje varësie nga përfaqësuesi legjislativ duke e bërë këtë të fundit të ndihet i pushtetshëm për dy arsye të qenësishme: së pari, sepse ka arritur t'i fitojë mendjen elektoratit duke përfituar kështu një shumësi votash; dhe së dyti, sepse ka një jetëgjatësi politike, e ardhur kjo si rezultat i faktit që ka qënë pjesë e grupeve parlamentare në disa legjislatura të njëpasnjëshme dhe kjo për pasojë, i ka përforcuar pozitat e tij në vënd. Dhe në fakt historia ka treguar se individët me kohëzgjatjen më të madhe në jetën politike të vëndit, janë kthyer në personazhe të pandashme nga jeta e shqiptarëve. A ka ardhur koha për një ndryshim rrënjësor të kësaj mendësie që ka mbajtur në pushtet për 30 vite këtë kastë politikë?

- *Frekuenca e ndjekjes së seancave plenare nga ana e pjesëmarrësve të studimit, vërehet se është i një niveli të ulët.*



55.3% e pjesëmarrësve ndjekin pak zhvillimin e punimeve të Kuvëndit, 34.1% e tyre është shprehur se aspak nuk i ndjekin e ndërsa një përqindje e vogël prej 9.5% thonë se i ndjekin shumë. Në këtë mënyrë, ne arrijmë të kuptojmë se elektorati si publik është shumë pasiv në ndjekjen korrekte dhe periodike të seancave parlamentare. Ky pasivitet mund të vijë si rezultat i cënimit të imazhit institucional. Kur një parlament fiton shumë pak vëmëndje, kjo do të thotë se po i humbet kredibiliteti. Besimi është një element i lidhur drejtpërsëdrejti me opinionin publik. Ndër politikanët e parë që ishte i interesuar dhe respektonte opinionin publik ishte Abraham Linkoln, ai shprehimisht thoshte se “Simpatia e publikut është gjithçka, duke e pasur nuk do kesh dështime, por duke mos e pasur, asgjë nuk do të ketë sukses”.



Në pyetjen e rradhës, janë parashtruar disa alternativa si arsye kryesore për mungesën e interesit përkundrejt ndjekjes së Kuvëndit dhe rezultoi se 46.3% e tyre “nuk ndihen të përfaqësuar nga ligjvënësit” duke demonstruar kështu një rënie të kurbës së besimit përkundrejt tyre. Sigurisht që kur flitet për mungesën e respektimit të Kodit të Sjelljes së një deputeti në parlament, për mungesën e transparencës së aktivitetit të tij jashtë parlamentit, për konfliktet e shpeshta etike me të cilat ai/ajo përballet ku


interesat personale përplasen me interesat kombëtare; mënyra e përdorimit të shpërblimeve parlamentare; keqpërdorimi i informacionit në foltoren e parlamentit ku diskutohen për problemet konkrete të shqiptarëve, fryrje artificiale të shifrave në disa raste specifike, atëhere shqiptarët do të fillojnë të mos ndihen të përfaqësuar.

Pjesa tjetër ka zgjedhur alternativën se për shkak të “niveleve të dobëta të artikulimit publik”, 22.8% prej tyre nuk i ndjekin seancat për këtë motiv. Një artikulum i dobët i komunikimit publik është atëhere kur nuk praktikohet asnjë nga teknikat e propozuara të oratorit më të madh të kohërave Reagan. Shqiptarët mendojnë kështu për fjalimet e disa prej parlamentarëve për arsyet si më poshtë:

- Vërehen në disa raste se fjalimet janë shumë të gjata dhe nuk respektojnë minutazhin e përcaktuar me rregulloren e Kuvëndit. Sinjalizimet e vazhdueshme nga Kryetari i Kuvëndit për ndërprerjen e fjalimit, janë shqetësuese për audiencën.
- Vërehen në disa raste se fjalimet nuk janë të gjalla dhe energjike. Një fjalim duhet të ketë më shumë se një strukturë logjike, duhet të ketë fragmente që frymëzojnë si dhe ritëm. Një tregim, një surprizë, një grimcë humori kur askush nuk e pret, të gjitha këto bëhen për të mbajtur audiencë të mbërthyer, të relaksuar, të përfshirë.
- Në shumicën e artikulimeve publike, nuk gjenden fakte tërheqëse përveç se akuza të njëpasnjëshme ndaj njëri-tjetrit duke tejkalluar në nivel personal. Audiencia nuk interesohet për fakte të jetës private, por i duhen informacione të besueshme për jetën publike të vendit.

Ndërkohë 12.7% e të anketuarve janë shprehur se nuk i ndjekin seancat plenare për motivin e “sjelljeve joetike jashtë rregullores”. Mesa duket, shqiptarët mendojnë se parimi i respektimit të kundërshtarit politik është çënuar ndjeshëm në hapësirën parlamentare të Kuvëndit. Kur audienca vëren në shumicën e rasteve manifestime të shumta të sjelljeve jo etike si hedhja e çizmes, vezë, ofendime, shishet me molotov etj., atëhere kjo për ta është një arsye edhe më shumë për të ndërruar kanalën televiziv dhe për të mos e konsideruar më parlamentin si dhoma e debatit publik, si një forum ku çështjet kryesore të ditës si dhe politikat qeveritare diskutohen dhe trajtohen me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.


- *Shkalla e njohjes së deputetëve të Parlamentit Shqiptar nga trupi elektoral i vëndit.*



1197 Shqiptarë kanë zgjedhur që t’i përgjigjen kësaj pyetjeje, e cila qëllimin e ka patur për të testuar se a njihen të gjithë individët që janë pjesë e grupeve parlamentare si dhe deputetët që kanë kandiduar si të pavarur. Dhe rezultoi se 61.2% i njohin fare pak

deputetët e Kuvëndit. Njohja e pakët e ligjvënësve, e atyre që janë të rekrutuar politikisht falë votave të shqiptarëve vjen si rezultat i dy faktorëve relevante:


- Elektorati nuk i ka votuar kandidatët për deputet në listat e çdo partie. Elektorati ka votuar vetëm kryetarin, pra liderin politik të partisë. Ky elektorat nuk i njeh të gjithë, pasi nuk i ka përcaktuar si individë përfaqësuesit e saj në Kuvënd, por i ka zgjedhur përmes siglës partiake.
- Nuk janë që të gjithë përfaqësuesit legjislativ aktiv në të folurin publik në seancat parlamentare, kjo i bën që shqiptarët të jenë të prezantuar publikisht vetëm me disa personazhe politike të parlamentit.
- *A kanë arritur të perceptojnë shqiptarët figura intelektuale në Parlamentin Shqiptar?*



1194 Shqiptarë kanë zgjedhur t'i përgjigjen pyetjes së rradhës, duke rezultuar 59.1% e tyre nuk shikojnë përfaqësues dinjitoz me kredenciale pozitive në Parlament. Ky është një sinjal shumë i fortë për liderët e partive që të mos propozojnë emra kandidatësh

nëpër lista zgjedhore, individë të cilët nuk arrijnë të justifikojnë besimin e kryetarëve të tyre. Ndërsa 31% prej tyre shikojnë figura intelektualësh të cilët nuk janë të mandatuar për të respektuar vetëm disiplinën partiake, duke vepruar brënda unitetit, por dijnë edhe të respektojnë në vazhdimësi disiplinën parlamentare. 9.9% kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

- *Informimi mbi ligjet e miratuara në Kuvend*



1195 nga totali i të anketuarve vendosën t'i përgjigjen kësaj pyetjeje, duke rezultuar se 83.7% e pjesëmarrësve nuk janë në dijeni për të gjitha projektligjet që kalojnë për diskutim në parlament, për të cilat zhvillohet një proces legjislativ e që miratohet në fund. Kjo shpjegon mangësinë e një dialogu midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve, por mbi të gjitha devijimin e vëmendjes gjatë seancës në debate personale me zhargon fyes për tema që janë jashtë rendit të ditës. Pasqyrimi mediatik në edicionet informative I kushton rëndësi batutave dhe konflikteve duke I lënë pak vend në fund ligjeve të miratuara dhe mënyrën sesi do prekin jetën e qytetarëve. Njohja e ligjeve nga qytetarët është nje proces i rëndesishem per te konformuar sjelljet e tyre

ne vend. Dhe kjo shifer, tregon se pjesemarresit qe i perkasin nje arsimimi te larte nuk jane te perditesuar me te gjitha ligjet e publikuara ne fletoren zyrtare. Nje pakice e vogel prej 14.2% i njohin ne menyre te detajuar cdo ligj te kaluar ne Parlament. Dr. Ylli Bufi (2010, fq. 607) na sjell ne vemendje rastin e nje vendi te vogel si Luksemburgu, ku cdo vit ka nje raport vjetor te Dhomes se Deputeteve e cila shperndahet ne cdo qender te vendit. Dergimi nga cdo parlamentar per zgjedhesit e tij te nje raporti mbi veprimtarine e tij ne fund te cdo sesioni, sherben jo vetem per informimin e tyre, por sidomos flet per pergjegjesine e tij ndaj zgjedhesve jo vetem ne periudha zgjedhore. Mungesa e ketij modeli te transparences, ka ndikuar jo vetem qe shqiptaret nuk i njohin te gjitha deputetet, por ç'është më e rëndësishmja nuk njohin të gjitha ligjet qe miratohen dhe ndikojnë tek vetë ata.

II. Gjetjet kërkimore të studimit

II.1. Arsyetime të tjera të dhëna se përse nuk janë shikues të rregullt të seancave plenare të Kuvëndit.

Nga analiza e të dhënave rezulton se pjesëmarrësit e studimit e që njëherësh janë pjesë e trupit elektorale të vëndit, ndihen aspak të përfaqësuar nga parlamentarët, pasi perceptohen si individë të varësuar nga kryetarët e partive ku aderojnë dhe komunikimi me ta është prioriteti i tyre parësor në krahasim me zgjedhësit.

Pjesëmarrësi/ja Nr.571/ ora 00:01: “Nivel i ulët. Edhe pse janë të zgjedhur për të na përfaqësuar vetë fakti që vendosen nga kryetari nëpër lista i bën ata të duken si të emëruar. Marrëdhënien e kanë më shumë me kryetarin sesa me zgjedhësin”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.241/ ora 10:50: “Nivel shumë i ulët i deputetëve, si nga ana morale ashtu edhe nga ana e kualifikimit arsimor apo edhe profesional. Si mund të ndihesh i përfaqësuar nga një deputete që nuk di të shqiptojë fjalën kooperatë”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.971/ ora 2:46: “Ndjej turp nga parlamentarët që na përfaqësojnë, të gjithë pa përjashtim”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.986/ ora 10:39: “Niveli i tyre shumë i ulët kulturor dhe servilizimi i tejskajshëm ndaj Liderit të Pozitës, i cili tallet me

Raport studimi

qytetarët në çdo seancë, më fyejnë inteligjencën dhe më bëjnë të ndjehem shumë keq. Ndjaj mënyra më e mirë është të mos ndjek asnjë séancë”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.365/ ora 13:44: “Kanë pasuri që si i kanë bërë, është puna jo e bërë nga shteti dhe janë shumë të pashkolluar nuk dinë as të flasën, po fatkeqësisht ato marrin vendime të rëndësishme për vëndin tonë”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.772/ ora 9:26: “Fjalor i papërshtatshëm. Jo etike në sjellje. Diskutim politik dhe jo për interes të publikut”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.749/ ora 5:08: “Parlamenti është show Teatral”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.203/ ora 12:07: “Shpesh herë shoh debate të cilat devijojnë nga konteksti për të cilin duhet diskutuar. Kapjet për qëllime personale me njërin-tjetrin degjenerojnë në një nivel skandaloz që me të vërtetë është sa për të qeshur aq edhe për të qarë kur vjen fjala se cilët janë ata që na drejtojnë dhe që drejtojnë këtë vënd tonin”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.742/ ora 0:33: “Dalje jashtë teme, gjithmonë bëhet politike dhe inate personale, klanore ose politike kur duhet të diskutohen ligjet, shumë pak diskutohen vërtete ligjet”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.805/ ora 23:11:“Përgjithsisht nivel i dobët i deputetëve. Kjo ka sjellë shumë pak diskutime profesionale në diskutimin e projektligjeve”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.959/ ora 14:06: “cilësi e dobët e argumenti; nivel denigrues komunikimi; negativiteti, fyerje, tone të larta dhe shembull i keq i mënyrës së të bërit debat”.

II. Gjetjet kërkimore të studimit

Pjesëmarrësi/ja Nr.697/ ora 5:26: “Debate pa sens që në fund nuk zgjidhin asnjë nga problemet që parashtrohen në nisje të seancës. Nuk merren më thelbin, por me akuza e detaje pa lidhje”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.410/ ora 5:27: “I kam ndjekur për mbi 10 vjet me interes po sot nuk shikoj asnjë seancë sepse shikoj vetëm gënjeshtër dhe estradë kto 10 vitet e fundit...adhurimi për politikën me është kthyer në zhgënjim nuk shikoj më as lajme për këtë arsye”.


Pjesëmarrësi/ja Nr.273/ ora 23:29: “Arsyeja kryesore që nuk i ndjek seancat e parlamentit është sepse të gjitha partit politike janë të korruptuar, bëjnë sikur interesohen për popullin kur në të vërtetë janë të gjitha fasada. Sjellja e tyre jo etike në seanca të bëjnë të mendosh sikur po sheh humor +18. (më falni për fjalorin)”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.983/ ora 10:15: “Nuk i ndjek seancat e parlamentit për arsye se, nuk synojnë të zgjidhin problemin e popullit, por zihen me njërin-tjetrin. Dhe më fort po shkatërrojnë shtresën e mesme dhe të ulët ekonomike sesa po vendosin drejtësinë”.

Pjesëmarrësi/ja Nr.937/ ora 5:44: “S’kanë bërë ndonjë gjë të hajrit këta politikanë të këqinj as që moti, as sot, e as kanë për të bërë, për ca ti ndjekësh kur ata tallen hapur me popullin”.


Pjesëmarrësi/ja Nr.101/ ora 13:18: “Ka shumë pak përgjegjësi parlamentare dhe kulturë parlamentare”.

II.2. Diagrama logjike e temave



Kjo diagramë përmban një lidhje konceptuale midis 7 temave kryesore të përfuara përgjatë procesit të përpunimit dhe analizimit të të dhënave të grumbulluara. Pjesëmarrësit e studimit mendojnë se kualifikimet arsimore nuk arrijnë të justifikohen siç duhet nga një pjesë e konsiderueshme e përfaqësueve politik pavarësisht qasjeve dhe bindjeve politike. Treguesit e këtij fakti janë papërgjegjshmëria parlamentare, performanca e dobët si dhe thyerja e etikës. Të tria këto koncepte shtrihen në lidhje paralele me njëra-tjetrën. Papërgjegjshmëria parlamentare provokon një mungesë të theksuar të frymëzimit të besimit. Kjo rënie e kredibilitetit mbi imazhin e anëtarëve të Parlamentit si pjesë e tempullit të demokracisë, perceptohet nga ana e qytetarëve si një shfaqje teatrale dhe kjo shoqërohet me një rënie të theksuar të interesimit nga ana e elektoratit.

II.3. Hierarkia e piramides se 5 problemeve prioritare të studimit



III. Përfundimet nga analiza e të dhënave

- 1) Aspekti personal që lidhet me paraqitjen e jashtme fizike, përdorimi i një kodi komunikues të papërshtatshëm, si dhe mungesa e koherencës duke shprehur qëndrime kundërthënëse në fjalime, janë faktorë që ndikojnë negativisht në deformimin e imazhit të një parlamentar.
- 2) Kritika e opinionit publik i është drejtuar here pas here edhe stilit të veshjeve të disa prej parlamentarëve në legjislatura të mëparshme. Janë evidentuar raste konkrete, të një gruaje e postit ministror, e cila referonte në foltore e veshur me një dekolte të hapur apo e një deputeti burrë, i cili teksa përpiquej që të shqiptonte dy fjalë, në të njëjtën kohë mbante një kapele të stilit “kaubojs”. Mungesa e respektimit të kodit të veshjes dhe të etikës së komunikimit ka goditur imazhin jo vetëm në nivel personal, por edhe në atë institucional.
- 3) Disa përfaqësues legjislativ në bazë të sondazhimit të opinionit publik, kanë vështirësi në ndërtimin e fjalimeve frymëzuese, argumentuese dhe të artikulimit bindës. Kjo ka impaktuar negativisht tek një pjesë e mirë e elektoratit në Shqipëri, duke menduar se në parlament ka mungesa të theksuara të figurave intelektuale.
- 4) Deputetët kanë marrëdhënie më të drejtpërdrejta dhe më të afërt më shumë me kryetarët e partive të tyre se sa me elektoratin e tyre; si rrjedhojë zgjedhësit shqiptarë nuk janë

të informuar periodikisht për veprimtarinë e deputetëve në legjislaturën ku ata/ato janë aktive nën statusin e parlamentarit.

- 5) Zgjedhësit shqiptarë rezultojnë të jenë shumë të pakënaqur me kulturën e dobët politike që është demonstruar ndër vite dhe që vijon të shfaqet në parlamentin aktual. Rënie e besueshmërisë mbi figurat e tanishëm politike iu ka krijuar atyre përshtypjen e një tragji-komedie teatrale ku perdet hapen e mbyllen në paraditen e të enjtes.
- 6) 83.7% e të sondazhuarve nuk janë të njohur me të gjitha ligjet e shtetit të tyre. Kjo ndikon në krijimin e një vakumi të theksuar në ndërgjegjësimin e masës popullore në respektimin dhe zbatimin e akteve ligjore.
- 7) Listat zgjedhore të mbyllura shkakton mungesën e një transparence politike. Votuesit shqiptarë nuk gëzojnë të drejtën e njohjes konkrete të çdo kandidature për deputet për të cilët zgjedhësit vendosin më pas nëse duan apo jo që t'i votojnë. Dhe çfarë ndodh më pas? Që 61.2% e shqiptarëve nuk i njohin që të gjithë deputetët që votojnë ligjet e shtetit të tyre; ata njohin partinë dhe liderin për të cilën kanë votuar dhe jo të gjithë individët ku aderojnë në të.

IV. Rekomandimet e propozuara për përmirësimin e këtij parlametarizmi

1. Në momentin e krijimit të listave zgjedhore, liderët politike duhet të kenë në vëmendje teorinë elitiste të politikës, pasi mendohet se ajo duhet të jetë mbi mesataren e kulturës politike të masës së popullsisë. Listat zgjedhore duhet të përmbajë kandidatura të individëve të arsimuar me rezultate të shkëlqyera akademike dhe jo vetëm; me ekspertizën e duhur në fushën profesionale ku është i/e formuar; vendimmarrës të denjë për masën e të qeverisurve; si dhe orator të mirë të komunikimit politik.
1. Transparenca e procesit zgjedhor nis që nga hapja e listave zgjedhore, prandaj rekomandohen listat e hapura. Votuesit kanë të drejtë të jenë të prezantuar me emrat konkrete që kanë propozuar kryetarët e partive politike.
2. Deputetët të dorëzojnë raporte mujore elektoratit të tyre për çdo veprimtari të kryer në kuadër të çështjeve publike të vëndit.
3. Parlamentarët që kanë probleme të theksuara të ligjërimit, të trajnohen në sesione të veçanta për përmirësimin e komunikimit publik. Pavarësisht moshës dhe përvojës të dikujt, e folura publike është një aftësi që edhe mund të fitohet në rastet kur nuk e ke si zotësi vetjake.

IV. Rekomandimet e propozuara për përmirësimin e këtij parlametarizmi

4. Parlamenti si organ i rekrutimit politik, sugjerohet që në fund të çdo viti të ketë një sistem vlerësimi për performancën e çdo deputeti në të gjitha grupet parlamentare. Një pasqyrim i tillë do të ndihmonte në evidentimin e disa përfaqësueve legjislativ që do të shërbejnë si modele referimi për të gjithë ata të rinj që synojnë një karrierë politike.
5. Transparenca e vazhdueshme financiare e çdo deputeti, është një kusht i domosdoshëm që nuk duhet neglizhuar për të rritur besueshmërinë tek shqiptarët.

V. Argumenti përmbyllës

Në skenën politike të vëndit, do të ishte mirë për shqiptarët që të shikonin disa figura të reja që t'i qasen disa roleve klasike të dikurshme. Të gjejmë midis tyre një *Hero* si *Charles de Gaulle*; një *njeriu të zakonshëm* sikurse *Jimmy Carter*; një *lider tërheqës* si *Kennedy* që njihhte politikën e artit të joshjes; apo një *baba* të dashur për popullin, të zgjuarin si *Conrad Adenauer*. Nuk është e lehtë të përfaqësosh dhe të përfaqësohesh. Është përgjegjësi të zgjedhësh dikë, sikundër është përgjegjësi e deleguar nga dikush që te qeverisesh. Ka ardhur koha që legjislatorët, ekzekutuesit dhe gjyqtarët e këtij kombi të ndërgjegjësohen për peshën e punës së tyre, ka ardhur koha që qytetarët të ndërgjegjësohen për lirinë e votës, për ta mbajtur atë të pastër nga çdo dorë që kërkon ta njollojë. Shqiptarët duhet të nisin t'i japin peshën që duhet votës se tyre, sepse vetëm kështu do të mund të vi ndryshimin i pasforcuar demokratik.